

Erziehungsdirektion  
des Kantons Bern


Direction de  
l'instruction publique du  
canton de Berne

Amt für Kindergarten,  
Volksschule und Beratung

Office de l'enseignement  
préscolaire et obligatoire, du  
conseil et de l'orientation

## Shkolla fillore në kantonin e Bernës

Informacione për prindërit  
pjesa frëngjishtfolëse e kantonit



Informations pour les parents de la partie francophone du canton

Albanais

## Parathënia e drejtorit të arsimit

Të dashur prindër

Gjatë viteve të para të të mësuarit kopshti i fëmijëve dhe shkolla bëhen përmbajtjet më të rëndësishme të jetës. Fëmijët në këtë moshë zhyten një botë të mrekullueshme, në të cilën bashkësia me shoqet dhe shokët e tyre të klasës luan një rol të veçantë.

Për mua në qendër është gjithmonë mirëqenia e fëmijës, marrëdhëniet e tij me arsimtarët dhe besimi i prindërve ndaj shkollës. Partneriteti i fortë dhe i orientuar për të ardhmen midis shkollës dhe prindërve është baza për zhvillimin e mëtejshëm të fëmijëve. Këtë ndërveprim e kam shumë për zemër.

Si prindër ju mund të kontribuoni shumë për mbarëvajtjen mund ta shoqëroni dhe fëmijën tuaj në rrugën e tij të mëtejshme të jetës shkollore në mënyrë të kujdesshme dhe duke e mbështetur. Në këtë broshurë ne kemi përmbledhur informacionet më të rëndësishme, të cilat do t'ju ndihmojnë që të orientoheni në sistemin tonë shkollor.

Këtu ju gjeni, midis të tjerash, përgjigje për pyetjet:

- Si janë ndërtuar kopshti i fëmijëve dhe shkolla?
- Çfarë pritet nga prindërit?
- Çarë mund të bëj unë që fëmija im të ndihet mirë në shkollë dhe të mund të mësojë mirë?

Arsimtarët dhe drejtorja e shkollës së fëmijës suaj me ju qëndrojnë me kënaqësi në dispozicionin për informacione të mëtejshme. Ju lutem, vini re edhe faqen tonë të internetit [www.erz.be.ch](http://www.erz.be.ch), prezencën në internet të komunës suaj dhe të shkollës së fëmijës suaj.

Ne i urojmë fëmijës suaj dhe juve si prindër një kohë të mirë në kopsht dhe në shkollë.

Bernhard Pulver  
Drejtor i arsimit i kantonit Bernë



*Bernhard Pulver, drejtor i arsimit*

<b>1</b>	<b>Më të rëndësishmet me pak fjalë .....</b>	<b>3</b>
	Të përgjithshmet .....	3
	Viti shkollor dhe pushimet shkollore .....	3
	Orari i mësimëve .....	3
	Shkolla ditore .....	4
	Detyrat e shtëpisë .....	4
	Vlerësimi .....	4
	Mungesa dhe çlirime .....	4
	Oferta plotësuese për arsim dhe për kohën e lirë .....	5
	Shëndeti .....	5
<b>2</b>	<b>Shkolla fillore .....</b>	<b>6</b>
	Objektivat dhe organizimi .....	6
	Kopshti (klasat 1 - 2) .....	6
	Shkalla primare (klasat 3 - 8) .....	6
	Kalimi nga shkalla primare në shkallën sekondare I ..	7
	Shkalla sekondare I (klasat 9 - 11) .....	7
	Fëmijë dhe të rinj të sapoardhur .....	8
<b>3</b>	<b>Pas shkollës fillore .....</b>	<b>9</b>
	Mundësitë e formimit .....	9
	Formimi profesional bazë (mësimi profesional) .....	9
	Shkollat e mesme .....	9
	Zgjidhje të ndërmjetme .....	9
	Informacione të tjera .....	9
<b>4</b>	<b>Prindërit dhe shkolla fillore .....</b>	<b>10</b>
	Bashkëpunimi .....	10
	Informacioni i ndërsjellë .....	10
	Përkthimi .....	10
	Vendime të rëndësishme .....	11
	Bashkëveprimi .....	11
<b>5</b>	<b>Situata të vështira në shkollën fillore .....</b>	<b>12</b>
	Procedimi në situata të vështira .....	12
	Masat në rast të problemeve disiplinore .....	12
<b>6</b>	<b>Situata të vështira në edukim .....</b>	<b>12</b>
	Këshillimi nga persona të specializuar .....	12
<b>7</b>	<b>Të kontribuoni si prindër në suksesin shkollor .....</b>	<b>13</b>
	Tregoni interes .....	13
	Motivoni dhe mbështetni .....	13
	Nxitja e gjuhës dhe e përvojave të veta .....	13
	Rregulloni kontaktin me media të reja .....	13
<b>8</b>	<b>Glosar .....</b>	<b>14</b>

### **Udhëzim**

Kantoni i Bernës ka një pjesë gjermanishtfolëse dhe një pjesë frëngjishtfolëse të kantonit. Informacionet në këtë broshurë i referohen pjesës frëngjishtfolëse të kantonit. Nociione të rëndësishme në frëngjisht theksohen me shkrim jeshil.

# 1 Më të rëndësishmet me pak fjalë

## Të përgjithshmet

### Généralités

- Shkollimi i detyrueshëm zgjat, si rregull, njëmbëdhjetë vjet. Hyrja në kopshtin e fëmijëve bëhet në moshën katërvjeçare. Pas kohës së detyrueshme të shkollës të rinjtë dhe të rejtat vizitojnë një kualifikim dy deri katërvjeçar, gjatë të cilit ata mësojnë një profesion ose ata vizitojnë një shkollë të mesme.

	<b>Shkalla sekondare II</b> <i>Degré secondaire II</i> Formim profesional ose shkollë e mesme	2-4 vite
<b>Shkolla fillore</b> <i>Ecole obligatoire</i>	<b>Shkalla sekondare I (klasat 9 – 11)</b> <i>Degré secondaire I</i> e detyrueshme <ul style="list-style-type: none"><li>- mësim në tre nivele të ndryshme të kërkesave</li><li>- përgatitje për zgjedhjen e profesionit</li></ul>	3 vite
	<b>Shkalla primare (klasat 3 – 8)</b> <i>Degré primaire</i> e detyrueshme <ul style="list-style-type: none"><li>- Gjatë klasës së 8-të procedura e kalimit: Përcaktimi për nivelet e ndryshme të kërkesave për shkollën sekondare I</li></ul>	6 vite
	<b>Kopshti (klasat 1 – 2)</b> <i>Ecole infantine</i> i detyrueshëm, hyrja në moshën 4 vjeçare	2 vite

- Të gjithë fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtën për vizitën falas të kopshtit dhe të shkollës në vendqëndrimin e tyre. Komuna u jep falas nxënësve dhe nxënësve mjetet mësimore dhe materialet shkollore.
- Vajzat dhe djemtë shkolohen parimisht së bashku. Për të dyja gjinitë vlejné të njëjtat objektiva arsimore.
- Shkolla fillore publike është neutrale për sa i përket fesë. Në kuptimin e formimit të përgjithshëm dhe të edukimit për respekt ndaj njerëzve që mendojnë ndryshe ose kanë një fe të ndryshme tematizohen fetë e ndryshme gjatë mësimt. Si shoqëri e karakterizuar nga feja kristiane zakonet për festa kristiane, si p.sh. krishtlindjet, zënë vendin e tyre në mësim. Liria e fesë e të gjithë fëmijët dhe të rinjtë si dhe ajo e prindërve të tyre respektohet lidhur me këtë.
- Krahas shkollës fillore ka edhe shkolla private. Për këto nevojitet një miratim i drejtorisë së edukimit dha vizita e tyre është me pagesë.

- Fëmijët dhe të rinjtë me një kufizim fizik ose mendor vizitojnë, sipas mundësisë, shkollën fillore ose një shkollë të veçantë që u përgjigjet nevojave të tyre. Informacion për mundësitë përshtatëse të shkollimit dhe të nxitjes (edhe për fëmijë nën katër vjeç) merrni tek këshillimoret kantonale për edukim në regjionin tuaj: [www.erz.be.ch/spe](http://www.erz.be.ch/spe).

## Viti shkollor dhe pushimet shkollore

### Année scolaire et vacances

Viti shkollor fillon në mes të gushtit dhe mbaron në fillim të korrikut. Fëmijët dhe të rinjtë kanë 38 ose 39 javë mësim në vit. Pushimet janë të shpërndara gjatë gjithë vitit shkollor.

**Pushimet e vjeshtës** në shtator, tetor: dy javë

**Pushimet dimërore** në dhjetor, janar: dy javë

**Pushimet e sportit:** një javë

**Pushimet e pranverës** në prill dy javë

**Pushimet verore** në korrik, gusht: gjashtë javë

Të dhënat e sakta për pushimet dhe ditët e festave pa shkollë ju i merrni tek komuna juaj.

## Orari i mësimave

### Horaires

Mësimi bëhet nga e hëna deri të premten. Një orë mësimi zgjat 45 minuta. Paradite jepen të paktën katër orë mësimi me fillim dhe përfundim të njëlojtë (kohë blloku). Pasdite koha e mësimave varijon (dy deri katër orë mësimi). Sipas klasës një deri katër pasdite janë pa shkollë. Të mërkurën pasdite në kopshtin e fëmijëve dhe në shkollën primare nuk zhvillohet mësim. Orari i mësimave të fëmijës suaj për vitin e ardhshëm shkollor jepet nga personi mësimdhënës i klasës.

Si prindër ju jeni të detyruar të kujdeseni që fëmija juaj të vizitojë mësimin sipas orarit të mësimave. Jashtë kohëve të mësimt dhe në rrugën për në shkollë ju mbani përgjegjësi për fëmijën tuaj.

Shih edhe „Mungesat dhe çlirimet“ (f. 4) dhe „Prindërit dhe shkolla“ (f. 10).



## Shkolla ditore

*Ecole à journée continue*

Për fëmijët, të cilët para mësimit, gjatë drekës ose pas mbarimit të mësimit kanë nevojë për **përkujdesje**, komuna në rast të kërkesave të mjaftueshme ofron një shkollë ditore; në shumicën e rasteve në ambientet e shkollës fillore.

Shkolla ditore mund të përbëhet nga tre oferta të ndryshme:

- Përkujdesje në mëngjes para fillimit të mësimit
- Përkujdesje gjatë drekës me ushqim
- Përkujdesja gjatë pasditeve pas mbarimit të mësimit ose në pasditet pa shkollë

Në ofertën e drekës dhe të pasditeve përfshihet edhe mbështetja për kryerjen e detyrave të shtëpisë. Prindërit mund t' i zgjedhin ofertat sipas nevojave të tyre. Ofertat e shkollës ditore janë me pagesë. Kostot orientohen në të ardhurat, pasurinë dhe madhësinë e familjes.

Për informacione më të hollësishme për ofertën e shkollës ditore vizitoni [www.erz.be.ch/ecole-journee-continue](http://www.erz.be.ch/ecole-journee-continue) ose drejtohuni kujdestarit të klasës ose drejtorisë së shkollës.

Mundësi të tjera për përkujdesjen e fëmijëve jashtë familjes (qendrat e kujdesit ditor për fëmijë, prindër ditorë etj.) ju gjeni në [www.gef.be.ch](http://www.gef.be.ch) > Famille

## Detyrat e shtëpisë

*Devoirs à la maison*

Detyrat e shtëpisë janë një plotësim për mësimin. Me detyrat e shtëpisë thellohen dhe ushtrohen përmbajtjet e mësimit. Kini kujdes që fëmija juaj të ketë në dispozicion një vend të qetë dhe t' i bëjë detyrat e shtëpisë.

Detyrat e shtëpisë duhet të mund të kryhen pa ndihme përmbajtësore të prindërve. Nëse ju vini re që fëmija juaj nuk është në gjendje që t' i kryejë vetë

detyrat e shtëpisë, flisni me kohë me një person mësimdhënës.

## Vlerësimi

*Evaluation*

Të paktën një herë në vit zhvillohet në të gjitha shkollët një **bisedë** midis personave mësimdhënës të klasës dhe prindërve. Në këtë bisedë flitet për përparimin e të mësuarit dhe për sjelljen e punës dhe atë sociale të fëmijës suaj.

Fëmijët e klasave 3 deri 8 marrin në fund të vitit shkollor një **raport vlerësimi** me shkrim. Ai informon si janë arritur qëllimet e mësimit në lëndët e veçanta. Që nga klasa e 5-të arrijtjet e nxënësve dhe nxënësve në raportin e vlerësimit dokumentohen edhe me nota. Fëmijët e klasave 9 deri 11 marrin raportin me shkrim të vlerësimit gjithmonë në fund të semestrit. Në atë vlerësohet edhe sjellja e punës dhe ajo e të mësuarit.

Shkalla e notave shkon nga 1 deri 6 (6 = nota më e mirë, më pak se 4 = qëllimet e mësimit nuk janë arritur). Jepen edhe gjysmë nota (p.sh. 5.5 ose 4.5).

Për informacione të detajuara për vlerësimin në gjuhë të ndryshme shih: [www.erz.be.ch/evaluation](http://www.erz.be.ch/evaluation)

## Mungesa dhe çlirime

*Absences et dispenses*

- Si prindërit ju jeni të detyruar që ta çoni fëmijën tuaj sipas orarit të mësimeve në kopsht ose në shkollë. Prindërit të cilët me dashje nuk i çojnë fëmijët e tyre në shkollë mund të vuajnë një dënim.
- Si prindër ju i njoftoni personat mësimdhënës për arsyet e mungesës së fëmijës suaj: **Mungesa** të parashikueshme duhet t'i njoftohen paraprakisht personit përkatës mësimdhënës. Mungesa të cilat nuk mund të parashikohen duhet të njoftohen, për shkaqe të sigurisë, sa më shpejt që të jetë e mundur.
- Mungesa të fëmijës suaj konsiderohen të arsyetuara (miratuara) për arsyet që vijojnë: Sëmundje ose aksident i fëmijës, sëmundje ose rast vdekjeje në familje, ndërrimi i banesës, terminë tek mjeku dhe dentisti.
- Numri i orëve të mësimit të cilët një fëmijë ka munguar në mënyrë të arsyetuar dhe eventualisht të paarsyetuar shënohet në raportin e vlerësimit.

- Për miratimin e **çlirimeve** duhet që të paraqitet katër javë paraprakisht tek drejtorja e shkollës një kërkesë e arsyetuar me shkrim. Çlirime mund të jepen për arsye që vijnë: Festimi i festave të larta fetare, vizita e kursit në gjuhën dhe kulturën amtare (**LCO**), kryerja e stazhit njohës profesional.
- Për fëmijën e tyre prindërit kanë të **drejtë për deri në pesë gjysmëditë të lira për çdo vit shkollor**. Në këto gjysmëditë ai mund të mungojë në mësim pa dhënë arsye. Nëse ju dëshironi që të shfrytëzoni një gjysmëditë për fëmijën tuaj, atëherë njoftojeni për këtë personin mësimdhënës të klasës dy ditë më përpara.

### Oferta plotësuese për arsim dhe për kohën e lirë

*Offres de formation et de loisirs complémentaires*

Mësimi i detyrueshëm i shkollës plotësohet me **oferta fakultative shkollore**. Shkolla bën oferta në fushën e muzikës dhe të krijimit si dhe kurse ndërdisiplinore dhe projekte.

Në vitin e 9-të deri në vitin e 11-të të shkollës shtohen edhe oferta të tjera. Mësimi fakultativ është gjithashtu falas për prindërit.

**Në mësimin për gjuhën dhe kulturën amtare (LCO)** fëmijët dhe të rinjtë që rriten me shumë gjuhë mund t' i zgjerojnë kompetencat në gjuhën e tyre të parë (gjuha amtare ose atërore) dhe njohuritë e tyre mbi kulturën e origjinës së nënës ose babait. Bartës të këtij mësimi janë shtetet e vendeve të prejardhjes ose shoqata private. Ofertat janë pjesërisht me pagesë.

Më shumë informacione dhe një vështrim të përgjithshëm për ofertat gjeni nën: [www.erz.be.ch/lco](http://www.erz.be.ch/lco)

**Oferta sporti dhe oferta të tjera për kalimin e kohës së lirë** për fëmijë dhe të rinj organizohen në shumicën e rasteve nga shoqata private dhe bazohen në punën vullnetare. Si rregull për pjesëmarrjen në ofertat e shoqatave duhet të paguhet një kontribut vjetor.



Në **shkollën** rajonale të **muzikës** forca të kualifikuara mësimore ofrojnë mësimin e shumë instrumenteve.

Mësimi është me pagesë. Një pasqyrë mbi shkollat ekzistuese të muzikës gjeni nën:

[www.vbms.ch/ueber-uns/musikschulen/](http://www.vbms.ch/ueber-uns/musikschulen/)

Informacione mbi ofertat e sportit dhe ofertat të tjera për kohën e lirë merrni tek komuna juaj.

### Shëndeti

*Santé*

Fëmijë dhe të rinjtë vizitohen në kopshtin si dhe në klasën e 6-të dhe të 10-të nga **mjekja ose mjeku shkollor** i komunës. Vizita është e detyrueshme dhe falas. Ajo i shërben konstatimit me kohë të çrregullimeve shëndetësore si p.sh. defekte të dëgjimit, në të parë dhe të të folurit ose të qëndrimit dhe të lëvizjes. Nëse tek fëmija ka nevojë për sqarime të tjera ose për një trajtim, mjekja shkollore ose mjeku shkollor i informon prindërit dhe bisedon me ata procedurën e mëtejshme.

Edhe dhëmbët e fëmijëve dhe të të rinjve kontrollohen rregullisht nga **dentistja shkollore ose dentisti shkollor**. Kjo vizitë është gjithashtu e detyrueshme dhe falas. Nëse nevojiten trajtime, atëherë informohen prindërit. Kostot për këtë i mbajnë prindërit vetë. Në shkollën fillore fëmijët udhëzohen për **përkujdesjen** e mirë **për dhëmbët**.

Informojeni personin mësimdhënës të klasës nëse fëmija juaj vuan nga sëmundje ose duhet të marrë rregullisht medikamente.

Informacione për temën 'Fëmija & shëndeti' në gjuhë të ndryshme:

[www.migesplus.ch](http://www.migesplus.ch) > **Enfant & santé**

## 2 Shkolla fillore

### Objektivat dhe organizimi

*Objectifs et organisation*

Kopshti dhe shkolla nxisin fitimin e **dijes, aftësive, qëndrimeve dhe kompetencave për të vepruar** me qëllimin që fëmijët dhe të rinjtë të mund të orientohen dhe integrohen në ambient dhe shoqëri, të zhvillohen si një personalitet individual dhe me përgjithësi të plotë dhe të jenë në gjendje që pas shkollës së detyrueshme të kryejnë me sukses një kualifikim profesional ose një shkollë që çon më tej.

Personat mësimdhënës planifikojnë mësimin e tyre në bazë të **planeve mësimore**, në të cilat janë përcaktuar objektiva konkrete të kopshtit dhe shkollës.

Në çdo komunë **komisionet shkollore** mbajnë përgjegjësi dhe mbikëqyrin aktivitetet e kopshteve dhe shkollave fillore. Me porosi të drejtorisë për edukim **inspektoratet shkollore** sigurojnë mbikëqyrjen kantonale.

Për **regjistrimin për në kopsht** prindërit ftohen nga Komuna. Nëse prindërit dëshirojnë që fëmija e tyre të hyjë një vit më vonë në vitin e parë të kopshtit të fëmijëve, atë gjatë regjistrimit e njoftojnë për këtë autoritetin kompetent.

### Kopshti (klasat 1 - 2)

*Ecole enfantine*

Në kopsht fëmijët mësojnë **duke luajtur** dhe luajnë **duke mësuar**. Ata mësojnë që të perceptojnë më mirë vetveten, të integrohen në një grup më të madh prej fëmijësh dhe mbledhin përvoja në kontaktin me ambientin e tyre. Fëmijët nxiten në kopsht në gjithë zhvillimin e tyre dhe përgatiten për hyrjen në shkollë. Personi mësimdhënës i kopshtit vëzhgon dhe mbështet në mënyrë të pikësnyuar zhvillimin e secilit prej fëmijëve dhe i bisedon përparimet me prindërit.



Fëmijë të cilët në fusha të veçanta kanë nevojë për **nxitjen e veçantë** (për shembull në zhvillimin gjuhësor ose motorik) mbështeten nga persona të tjerë të specializuar.

Si rregull, kopshti zgjat dy vite. Sipas gjendjes së zhvillimit të fëmijës **kalimi i fëmijës në shkollën primare** mund të bëhet edhe një vit më vonë ose ënda mësimore e klasës së tretë mund të kryhet edhe në dy vite.

Një herë në vit bëhet një vlerësim i arritjeve për të vlerësuar gjendjen e zhvillimit dhe të njohurive të fëmijës.

Kalimi nga kopshti i fëmijëve në shkollën primare është një vendim mbi karrierën shkollor dhe vendoset nga drejtoria e shkollës me kërkesë të personave mësimdhënës të kopshtit të fëmijëve.

Fëmijë që rriten me shumë gjuhë, të cilët gjatë hyrjes në kopsht e kuptojnë vetëm pak gjuhën lokale, marrin mbështetje shtesë. **Njohuri të mira në frëngjisht janë vendimtare për suksesin e mëvonshëm të fëmijës suaj në shkollë.** Prandaj kini kujdes që fëmija juaj që para kohës së kopshtit të mund të luajë me fëmijë të tjerë dhe gjatë kësaj të mund të mësojë frëngjisht. Informohuni tek komuna juaj **për oferta për të luajtur dhe të përkujdesjes për fëmijë që nga mosha dy vjeçare** si takime për nëna dhe baballarë, grupe ku luajnë fëmijë ose qendrat e kujdesit ditor. Shih „Si prindër të kontribuoni në suksesin shkollor“ (f. 12).

Në disa komuna fëmijët e kopshtit të fëmijëve dhe të të dyja klasave të para shkollohen plotësisht ose pjesërisht (në mënyrë të përzier sipas moshës) (**Cycle élémentaire** ose **Basisstufe**).

### Shkalla primare (klasat 3 - 8)

*Primarstufe / Degré primaire*

Në klasat 3 deri 8 nxënëset dhe nxënësit fitojnë dhe forcojnë aftësitë bazë **lexim, shkrim dhe llogaritje**. Ata fitojnë njohuri për ambientin dhe mësohen me teknikat e punës. Shpesh herë në lëndë të ndryshme punohet në të njëjtën temë. Nxënëset dhe nxënësit mësojnë dhe punojnë gjithnjë e më shumë në mënyrë të pavarur dhe me vetpërgjegjësi.

Duke filluar që në klasën e 5-të nxënëset dhe nxënësit në pjesën gjermanishtfolëse të kantonit mësojnë si **gjuhë të parë të huaj frëngjisht**, ndërsa në pjesën frëngjishtfolëse të kantonit **gjermanisht**.

Që nga viti 2013 në të dy pjesët e kantonit do të mësohet **Anglisht** që nga klasa e 7-të.

Gjatë klasës së 8-të bëhet **procedura e kalimit** për ndërrimin e fëmijës suaj në **Degré secondaire I** (klasat 9 - 11) (shih faqen vijuese).

Fëmijë të cilët në fusha të veçanta (gjuhë, lëvizje, të mësuarit, vëmendje) kanë vështirësi që t' i arrijnë qëllimet e mësimin, mund të mësohen sipas qëllimeve të mësimin që përcaktohen individualisht ose mund të

mbështeten në mënyrë të veçantë nga forca mësimore të kualifikuara. Për këtë, **vështirësitë në të mësuarit** e fëmijës, me pëlqimin e prindërve sqarohen nga një zyrë e specializuar. Zyra e specializuar vlerëson nëse nevojitet mbështetja me anë të **mësimit special**.

**Mësimi special** (*l'enseignement spécialisé*) zhvillohet gjatë kohës së mësimit brenda klasës ose në grupe jashtë klasës. Përveç kësaj në shumë komuna për një fëmijë me vështirësi në të mësuarit ekziston mundësia që të vizitohet një **klasë të veçantë**. Një klasë e veçantë (*Classe spéciale*) ka më pak nxënës dhe nënës se sa një klasë e rregullt dhe mësimi jepet nga persona mësimdhënës të cilët janë kualifikuar në mënyrë të veçantë për të mbështetur fëmijë me vështirësi në të mësuar.

Edhe për **nxënëset dhe nxënësit me aftësi të veçanta** ka një ofertë speciale. Kusht për pjesëmarrjen është po ashtu vlerësimi nga një zyrë e specializuar.



### **Kalimi nga shkalla primare në shkallën sekondare I**

*Passage du degré primaire au degré secondaire I*

Një **procedurë kalimi** gjatë klasës së 8-të e rregullon ndërrimin e fëmijës suaj nga shkalla primare në shkallën sekondare

Mësimi në shkallën sekondare I (viti i 9-të –11-të i shkollës) është i ndarë në tre **nivele të ndryshme të kërkesave**. Prandaj pas vitit të 9-të nxënëset dhe nxënësit caktohen në bazë të arritjeve të tyre shkollore dhe të zhvillimit të parashikuar të tyre shkollor njërit prej niveleve të ndryshme të kërkesave. Personi mësimdhënës i klasës informon fëmijët dhe prindërit në klasën e shtatë mbi procedurën e kalimit

Shih edhe „Shkalla sekondare I“ (f. 7) dhe “Pas shkollës fillore“ (f. 9).

Informacione për vlerësimin në shkollën fillore dhe për kalimin në shkallën sekondare I në gjuhë të ndryshme gjeni nën: [www.erz.be.ch/evaluation](http://www.erz.be.ch/evaluation)  
> [Informations pour les parents](#)

### **Shkalla sekondare I (klasat 9 - 11)**

*Degré secondaire I*

Në shkallën sekondare I nxënëset dhe nxënësit mësohen sipas arritjeve të tyre në tre nivele të **ndryshme të kërkesave**:

Nxënëset dhe nxënësit kalojnë ose në *section générale* („*section g*“), në *section moderne* („*section m*“) ose në *section préparant aux écoles de maturité* („*section p*“). Në „*section m*“ dhe në „*section p*“ të rinjtë duhet të plotësojnë kërkesa më të larta. Klasat e ndryshme janë strehuar së bashku në të njëjtën godinë.

Mbështetja me anë të mësimit special si dhe klasa të veçanta ekzistojnë edhe në shkallën sekondare I.

Nga nxënëset dhe nxënësit në shkallën sekondare I pritet gjithnjë e më shumë punë e pavarur individuale ose në grupe. Formimi i përgjithshëm zgjerohet dhe thellohet. Përveç kësaj nxënëset dhe nxënësit përgatiten për zgjedhjen e formimit profesional ose për një shkollë që çon më tej. **Zgjedhja e profesionit** (*choix professionnel*) e të rinjve bazohet në interesa, pika të forta dhe arritje personale shkollore. Shkolla e mbështet këtë proces të rëndësishëm duke trajtuar gjatë mësimit tema përkatëse. Prindërit, personi mësimdhënës i klasës dhe këshillimorja për zgjedhjen e profesionit së bashku i shoqërojnë të rinjtë në procesin e tyre të vendimmarrjes.

Personi mësimdhënës i klasës informon me kohë të rinj dhe ju si prindër mbi **kërkesat dhe parashikimet** që lidhen me zgjedhjen e profesionit dhe **kërkimin për një vend të mësimit profesional**.

Shih edhe „Pas shkollës fillore“ (f. 9) dhe “Vlerësimi“ (f. 4).



## Fëmijë dhe të rinj të sapoardhur

### *Nouveaux arrivants*

Informacione mbi vizitën e fëmijës suaj në kopsht dhe në shkollë si të sapoardhur ju merrni tek komuna juaj. Ju mund ta regjistroni fëmijën tuaj edhe drejtpërdrejt tek drejtorja e shkollës përkatëse. Fëmija juaj i nënshtrohet detyrimit shkollor sapo të ndodhet në Zvicër dhe nëse do të rrijë disa muaj në Zvicër. Hyrja në kopsht dhe në shkollë është e mundshme gjatë gjithë vitit shkollor.

Fëmijë dhe të rinj të sapoardhur pas dëgjimit të prindërve dhe të trupit mësimor (p.sh. në bazë të dokumenteve vlerësuese) sipas moshës dhe duke i marrë parasysh vitet e kryera shkollore i caktohen klasës përkatëse (në nivelin e shkollës sekondare I edhe nivelit përkatës të kërkesave). Caktimi nga ana e drejtorisë së shkollës bëhet fillimisht në mënyrë të përkohshme.

Që nga klasa e 6-të mund të jetë me vlerë përsëritja e klasës së kryer akoma jashtë vendit për fëmijë dhe të rinj pa njohuri të gjuhës së mësimin për t' u siguruar atyre më shumë kohë për mësimin e gjuhës së mësimin dhe për mbushjen e boshllëqeve në lëndët mësimore.



Fëmijët dhe të rinjtë pa ose me pak njohuri të gjuhës së mësimin marrin mbështetje plotësuese. Mësimi shtesë në frëngjisht [**français langue seconde (fls)**] është falas dhe bëhet gjatë kohës së mësimin brenda dhe jashtë klasës.

Në komunat me karakterin e qyteteve fëmijët dhe të rinjtë pa njohuri të gjuhës së mësimin shkollohen shpeshherë fillimisht dhjetë javë intensivisht në gjuhën e mësimin.

Vizita e ofertave si klub sporti, shkolla ditore dhe mësimi në gjuhën dhe kulturën amtare (**LCO**) mund ta ndihmojë fëmijën tuaj që të orientohet **më shpejtë në gjuhën e re dhe ambientin e ri** dhe të integrohet në aspektin shoqëror.

Shihe edhe „Pas shkollës fillore“ (f. 9).

### 3 Pas shkollës fillore

#### Mundësitë e formimit

*Possibilités de formation*

Rruga për një profesion të caktuar ose për një shkollë që çon më tej mund të përshkohet ndryshe nga ajo që ju parashikoni: Ndryshe se sa përpara ose – nëse ju nuk jeni rritur në Zvicër – ndryshe se sa në vendin e origjinës suaj. Sot për shembull ka mbi 250 profesione që mund të mësohen direkt pas shkollës fillore.

Një formim i mëtejshëm pas kohës së shkollës së detyrueshme është me rëndësi të madhe për të ardhmen e fëmijës suaj. Pa mbarimin e një formimi profesional ose të një shkolle që çon më tej siguria e vendit të punës dhe rroga që mund të pritet janë të ulëta. Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të ngritjes mungojnë.

#### Formimi profesional bazë (mësimi profesional)

*La formation professionnelle initiale (apprentissage)*

Shumica e të rinjve mësojnë profesionin e tyre pas kohës së shkollës së detyrueshme në një formim profesional bazë (mësim profesional): Gjatë dy deri katër viteve ata marrin **formimin** e tyre **praktik në një ndërmarrje**. Njëkohësisht ata ndjekin dy deri tre ditë në javë shkollën e specializuar profesionale (*école professionnelle*), ku ata përvetësojnë gjithashtu njohuri specifike për profesionin dhe e thellojnë formimin e tyre të përgjithshëm. Midis asaj/atij që mëson, ndërmarrjes mësimore dhe shkollës së specializuar profesionale nënshkruhet një **kontratë mësimore**. Për disa profesione ekziston edhe mundësia e një formimi profesional vetëm në shkollë [*les écoles supérieures de commerce (ESC)* dhe *les écoles de métiers*].

Për shkak të kombinimit të formimit në ndërmarrje dhe në shkollë të rinjtë me diplomën e një formimi profesional bazë kanë, si rregull, shanse shumë të mira në tregun e punës. Përveç kësaj pas mbarimit të formimit profesional bazë ka mundësi të shumëllojshme të kualifikimit të mëtejshëm.

Në rast të arritjeve shumë të mira gjatë ose pas formimit profesional bazë është i mundshëm fitimi i maturës profesionale (*maturité professionnelle*) dhe kështu studimi në një shkollë të lartë të specializuar (*école spécialisée HES*).

Informacione më të hollësishme për formimin profesional bazë: [www.ers.be.ch/formation-professionnelle](http://www.ers.be.ch/formation-professionnelle)

#### Shkollat e mesme

*Les écoles moyennes*

**Shkolla e mesme** e specializuar [*école de culture générale (ECG)*] gjatë tre viteve përgatit për formimin në fushën e shëndetit dhe të edukimit/çështjeve sociale.

Për nxënëset dhe nxënësit me aftësi shkollore dhe me gatishmëri të madhe për arritje të larta ekziston mundësia që të vizitojnë **gjimnazin** (*gymnase*). Formimi gjimnazial fillon në vitin e 12-të shkollor dhe zgjat 3 vite. Gjimnazi ofron një formim të thelluar të përgjithshëm me pika të ndryshme të rëndësës. Diploma e mbarimit (*maturité*) mundëson hyrjen pa provime në një shkollë të lartë (universitet ose universitet teknik) ose me një praktikë njëvjeçare në një shkolle të lartë të specializuar.

Për **të rinjtë të sapoardhur** nga një kanton tjetër ose nga jashtë vendit, të cilët dëshirojnë të vazhdojnë formimin e tyre gjimnazial në kantonin e Bernës, ka një fletë udhëzuese në gjuhë të ndryshme: [www.ers.be.ch/admission-gymnase](http://www.ers.be.ch/admission-gymnase)

Informacione për shkollat e mesme të specializuara dhe gjimnazin:

[www.ers.be.ch/ecoles-moyennes](http://www.ers.be.ch/ecoles-moyennes)

#### Zgjidhje të ndërmjetme

*Solutions transitaires*

Nëse njohuritë shkollore ose njohuritë e gjuhës së mësimi të fëmijës suaj nuk mjaftojnë ende për hyrjen në formimin e synuar profesional në fund të vitit të 11-të shkollor, atëherë ekziston mundësia që të kryhet një **vit i 12-të shkollor parapërgatitor për profesionin**. Kjo ofertë është e hapur edhe për **të rinj të sapoardhur** në moshën 16 – 18 vjeç/e pa ose me pak njohuri të gjuhës së mësimi:

[www.ers.be.ch/apps](http://www.ers.be.ch/apps).

Informohuni me kohë për këtë zgjidhje dhe për zgjidhje të tjera të ndërmjetme tek personi mësimdhënës i klasës ose në qendrën rajonale për informacione për profesionet (*CIP*).

#### Informacione të tjera

*Plus d'informations*

Krahas formimeve të përmendura pas shkollës fillore ka edhe oferta të tjera.

Informacione për zgjedhjen e profesionit dhe vendndodhjet e qendrave rajonale për informacionin për profesionet (*centres OP*):

[www.ers.be.ch/orientation-professionnelle](http://www.ers.be.ch/orientation-professionnelle)

Informacion për zgjedhjen e profesionit në gjuhë të ndryshme: [www.berufsberatung.ch/dyn/8225.aspx](http://www.berufsberatung.ch/dyn/8225.aspx)

Rrugë formimi pas shkollës fillore: Grafiku [www.ers.be.ch/formation-professionnelle](http://www.ers.be.ch/formation-professionnelle)

### Bashkëpunimi

*Collaboration*

Prindërit dhe shkolla fillore janë të detyruar me ligj për të bashkëpunuar. Ky bashkëpunim duhet zhvillohet me partneritet. Lidhur me këtë sukcesi shkollor dhe mirëqenia e fëmijës janë gjithmonë në qendër.

### Informacioni i ndërsjellë

*Information mutuelle*

**Kopshti dhe shkollai informojnë** prindërit mbi ngjarje dhe plane të rëndësishme në lidhje me mësimin (aktivitete, udhëtime shkollore etj.) dhe me aktivitetet e shkollës (caktimi për shkollën ose klasën, kohët e mësimit etj.). Këto informacione bëhen me shkrim ose me rastet e informacionit si **mbrëmje të prindërve** dhe **ditët e vizitave**. Pritet, që sipas mundësive, në aktivitete të tilla të marrin pjesë **të dy prindërit**. Në rast se të të dy prindërit nuk mund të marrin pjesë, lajmëroni me gojë ose me shkrim personin mësimdhënës që e ka bërë ftesën dhe informohuni se si ju, megjithatë, mund t' i merrni informacionet.

Kopshti dhe shkollë i informojnë prindërit rregullisht mbi zhvillimin (shkollor) dhe sjelljen e fëmijës suaj. Në çdo vit shkollor zhvillohet të paktën një **bisedë me prindërit** (bisedë midis prindërve të nxënësës / nxënësit dhe personit mësimdhënës të klasës) (shih edhe „Vlerësimi“, f. 4). Pritet që në këtë, sipas mundësive, të marrin pjesë **të dy prindërit**. Termini caktohet në marrëveshje me ju.

Nëse ju ndiheni tepër pak të informuar mbi shkollën ose zhvillimin shkollor dhe sjelljen e fëmijës suaj, pyesni tek personi mësimdhënës i klasës ose tek drejtorja e shkollës.

Në marrëveshje me personin mësimdhënës të klasës juve ju lejohet juve që të bëni një **vizitë në mësimin** e fëmijës suaj.

**Informojeni personin mësimdhënës të klasës** mbi ndodhitë që mund të pengojnë fëmijën tuaj në zhvillimin dhe vëmendjen e tij.

Shih edhe „Mungesat“ (f. 4).

### Përkthimi

*Traduction*

Është me rëndësi që ju të **kuptoni** çfarë bisedohet në një mbrëmje për prindërit ose gjatë një bisede me prindërit. Gjithashtu është me rëndësi që ju mund të **shprehni kërkesat** tuaja dhe të mund të shtroni pyetje. Nëse njohuritë tuaja të gjuhës akoma nuk mjaftojnë për këtë, ju mund të sillni me vete një person të rritur i cili përkthen për ju. Veçanërisht për bisedën me prindërit mund të organizojë edhe shkolla një person, i cili përkthen. Personat që

nga shkolla për të përkthyer janë neutral, të kualifikuar për funksionin e tyre dhe i nënshtrohen detyrimit për të ruajtur fshehtësinë.

## Vendime të rëndësishme

*Décisions importantes*

Të gjitha vendimet e rëndësishme për karrierën shkollore (p.sh. kalimi nga kopshti në shkollën primare dhe nga shkolla primare në shkollën sekondare I, kalimi në klasën tjetër, caktimi për në një klasë të veçantë) bisedohen me fëmijën tuaj dhe me ju. Ju keni të drejtë që të informoheni, dëgjoheni dhe këshilloheni nga forcat përkatëse mësimdhënëse dhe nga drejtorja e shkollës dhe mund t' i shikoni të gjitha dosjet e lidhura me fëmijën tuaj. Një **vendim për karrierën shkollore** vendoset nga drejtorja e shkollës. Vendimi përfundimtar duhet t' ju njoftohet me shkrim dhe në formë të arsyetuar. Nëse ju nuk jeni dakord me këtë vendim, ju keni mundësi që të parashtroni një ankesë tek inspektorjati shkollor.

Shih edhe „Vlerësimi“ (f. 4).

## Bashkëveprimi

*Participation*

Nëse ju keni gatishmërinë dhe mundësinë që t' i përkrahni forcat mësimdhënëse, klasën ose shkollën e fëmijës suaj me ndihma të vogla si shoqërim gjatë ekskursioneve, mbështetje në rast projektsh, përkthime të vogla për prindërit e një fëmije tjetër etj., njoftojani këtë person mësimdhënës të klasës. Ndihi tilla kontribuojnë për marrëdhënie të mira midis prindërve dhe personave mësimdhënës dhe për një klimë të mirë në shkollë.

Shumë kopshte dhe shkolla kanë një **këshill të prindërve**, i cili përbëhet nga një deri dy përfaqësues të prindërve prej secilës klasë. Këta zgjidhen në fillim të vitit shkollor nga prindërit e klasës. Përfaqësuesit e prindërve bashkëpunojnë ngushtë me personin mësimdhënës të klasës. Bashkërisht ata nxisin kontaktin midis prindërve dhe personave mësimdhënës të klasës dhe shkëmbimin e mendimeve mbi çështjet edukative dhe organizative shkollore. Përfaqësuesit e prindërve ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve, mbështesin aktivitete dhe projekte të klasës dhe përfaqësojnë kërkesat e prindërve të klasës në këshillin e prindërve të shkollës. Këshilli i prindërve trajton tema, të cilat i përkasin të gjithë shkollës (ose të paktën një shkalle).

Më shumë mbi bashkëveprimin e prindërve në kopshtin ose në shkollën e fëmijës suaj mësoni tek personi mësimdhënës i klasës ose tek drejtorja e shkollës.

## 5 Situata të vështira në shkollën fillore

Ndoshta fëmija juaj nuk ndihet mirë në klasë ose arritjet e tij kanë rënë papritmas. Ndoshta fëmija juaj ka vështirësi me fëmijë të tjerë ose ju si prindër nuk jeni dakord me një vendim të një personi mësimdhënës.

### Procedimi në situata të vështira

*Marche à suivre dans des situations difficiles*

Në rast të situatave të vështira, të cilat i përkasin fëmijës suaj, personit mësimdhënës ose klasës, duhet të respektohet procedimi si vijon:

1. Prindërit dhe personi mësimdhënës lidhin kontakt me njëri-tjetrin. Ata bisedojnë situatën së bashku dhe kërkojnë një rrugë zgjidhjeje. Si rregull gjendet kështu një zgjidhje e kënaqshme.
2. Nëse prindërit dhe personi mësimdhënës nuk arrijnë të gjejnë një zgjidhje dhe njëra palë ose të dyja palët e konsiderojnë të nevojshme, zhvillohet një bisedë midis prindërve, personit mësimdhënës dhe drejtorisë së shkollës.
3. Nëse gjatë shfaqjes së pyetjeve ose problemeve të çdo lloji natyre nuk mund të gjendet asnjë zgjidhje e kënaqshme, ju mund t'ia parashtoni dëshirën tuaj komisionit shkollor.

Ky procedim duhet të respektohet nga prindërit dhe personat mësimdhënës. Nëse është e nevojshme mund të organizohet një përkthim.

### Masat në rast të problemeve disiplinore

*Mesures en cas de problèmes disciplinaires*

Shkolla fillore kujdeset për funksionimin e rregullt të shkollës, kështu që të gjithë fëmijët mund të ndihen mirë dhe mësojnë mirë. Nxënëset dhe nxënësit duhet t'ia respektojnë rregullat e shkollës për bashkëjetesën (rregulloren e shtëpisë në shkollë, rregullat e klasës) dhe duhet të ndjekin udhëzimet e personave mësimdhënës, të drejtorisë së shkollës dhe të personelit ushtrues. Nëse në mënyrë të përsëritur rregulla nuk respektohen ose shkelen rëndë, atëherë informohen prindërit dhe vlen procedimi në situata të vështira.

Nëse masat për të cilat është bërë një marrëveshje nuk sjellin asnjë ndryshim pozitiv, atëherë nga shkolla mund të konsultohen persona të specializuar. Nëse për shkak të sjelljes së një nxënëseje ose nxënësi funksionimi i rregullt i shkollës pengohet në mënyrë të konsiderueshme, komisioni shkollor mund të japë një vërejtje me shkrim ose mund ta paralajmërojë largimin nga shkolla. Për të garantuar një funksionim të rregullt komisioni shkollor mund të përjashtojë nxënëse dhe nxënës deri në dymbëdhjetë javë nga mësimi. Në rast të një largimi (të pjesshëm) organizohet nga personat e specializuar që janë ngarkuar me punë, së bashku me prindërit dhe shkollën një veprimtari e përshtatshme.

## 6 Situata të vështira në edukim

Edhe në rast të pyetjeve për edukimin ju mund t'ia drejtoheni personit mësimdhënës të klasës. Shkëmbeni mendimet edhe me prindër të tjerë për të mësuar se si sillen ata me situata të vështira.

### Këshillimi nga persona të specializuar

*Conseils prodigués par des spécialistes*

Krahas personave mësimdhënës të fëmijës suaj ju mund t'ia drejtoheni edhe personave të tjerë të specializuar: Mbështetje mund të ofrojë këshillimorja për edukim në regjionin tuaj.

**Këshillimorja për edukim** është e pranishme për ju:

- Nëse vështirësitë në edukim bëhen një barrë kaq e madhe, sa që ju vetë gati nuk mund ta përballoni vetëm (mosbindje, kokëfortësi, frikë, agresivitet, sherr midis vëllezërve dhe motrave, probleme në kontaktin me bashkëmoshatarët, situata të detyrave të vështira, konsum i madh i internetit, konsum i alkoolit, konsum i drogave, aktivitete problematike në kohën e lirë etj. ose p.sh. nëse fëmija është gjithmonë i trishtuar ose nuk do të hajë më).
- Nëse familja është në një situatë të vështirë (ndarje, shkurorëzim, ngarkesa të tjera familjare, etj.).
- Nëse fëmija ka vështirësi në shkollë (vështirësi në të mësuar, në arritje dhe në sjellje) dhe ka nevojë (me kërkesë të prindërve dhe të shkollës) për sqarime më të sakta për ta mbështetur.
- Nëse në një klasë/ndërtesë shkollore ka probleme (p.sh. dhunë, diskriminim).

Informacione të tjera në gjuhë të ndryshme dhe adresën e këshillimores në afërsinë tuaj ju e gjeni këtu: [www.erz.be.ch/spe](http://www.erz.be.ch/spe).

Disa komuna disponojnë një **punëtores sociale shkollore ose ose një ndërmjetësues shkollor**. Edhe këtyre personave të specializuar ju mund t'ia drejtoheni në rast të vështirësive. Këta persona të specializuar ju këshillojnë në kërkesën tuaj dhe nëse dëshironi ju mbështesin në planifikimin e hapave të tjerë.

Për biseda me personat e këshillimores për edukim ose të punës sociale shkollore mund të organizohet një përkthim nëse ky është i nevojshëm.

Të gjithë personat e specializuar i nënshtrohen detyrimit profesional për të ruajtur fshehtësinë.

## 7 Të kontribuoni si prindër në suksesin shkollor

Guri i themelit për një zhvillim të mirë të fëmijës suaj vendoset në vitet e para të jetës. Këshilla për jetën e përditshme të edukimit gjeni në broshurën me shumë gjuhë „I gatshëm për shkollë“ (*Prêt pour l'école*): [www.erz.be.ch/spe](http://www.erz.be.ch/spe).

Ju si prindër mund të kontribuoni në mënyrë vendimtare për një zhvillim të mirë shkollor të fëmijës suaj.

### Tregoni interes

- Mbani kontakt me forcat mësimore dhe merrni pjesë mundësisht në të gjitha aktivitetet e shkollës. Ju nëpërmjet kësaj i tregoni fëmijës suaj që shkolla është e rëndësishme. Shkëmbimi i mendimeve dhe bashkëpunimi me forcat mësimore ndihmojnë që fëmija juaj të mund të nxitet në mënyrë optimale.
- Lëreni që fëmija juaj t'ju tregojë çfarë ka përjetuar dhe mësuar në shkollë.

### Motivoni dhe mbështetni

- Kujdesni që fëmija juaj të mbërrijë në shkollë në gjendje të çlodhur dhe me një mëngjes të shëndetshëm në bark dhe një „Znuni“ në çantë.
- Mos e çoni fëmijën tuaj (me makinë) në shkollë. Ushtroni bashkë me atë rrugën e tij për në shkollë derisa ai të mund ta bëjë vetë atë me këmbë ose me biçikletë.
- Kini kujdes që fëmija juaj t'ju ketë bërë detyrat e tij të shtëpisë dhe ta ketë përgatitur çantën e tij për ditën tjetër shkollore.
- Kini besim në aftësinë e fëmijës suaj për të mësuar. Lëreni që ai të bëjë shumë gjëra vetë.
- Lavdëroni fëmijën tuaj për mundimet e tij gjatë të mësuarit dhe për qëndrimin në rast të vështirësive.
- Mos e kritikoni fëmijën tuaj për shkak të gabimeve, por mendoni së bashku me atë çfarë mund të mësojë nga këto.

### Nxitja e gjuhës dhe e përvojave të veta

- Flisni shumë me fëmijën që kur është i vogël. Tregojini atij çfarë po bëni dhe shpjegojini atij botën që e rrethon. Dëgjojeni atë me durim dhe përgjigjuni pyetjeve të tij. Tregojini atij tregime dhe lexojini atij.
- Bëni aktivitete të përbashkëta me fëmijën tuaj. Shkoni me atë në kopshtin zoologjik, shkoni me anije, në muze dhe në natyrë. Kështu fëmija juaj mund ta mësojë botën me të gjitha shqisat dhe mund të mësojë të kuptojë lidhjet.

- Vizitoni me fëmijën tuaj rregullisht biblioteka dhe inkurajoni atë për të lexuar

Fëmijë që rriten me shumë gjuhë:

- Flisni me fëmijën tuaj në atë gjuhë të cilën ju e dini më mirë. Qëndroni në atë gjuhë edhe kur fëmija juaj përgjigjet në frëngjisht.
- Kujdesuni që fëmija juaj të mund të mësojë frëngjisht që kur është i vogël. Ju vetë të hapur për gjuhën lokale dhe mësoni atë. Ju jeni një shembull për fëmijën tuaj.
- Çoni fëmijën tuaj në mësim në gjuhën dhe kulturën amtare (LCO): Nxitja e gjuhës (gjuhëve) të parë/para(gjuhës amtare/atërore) është e rëndësishme për një zhvillim të mirë të gjuhës.

Shih "Rritja me shumë gjuhë": [www.erz.be.ch/lco](http://www.erz.be.ch/lco)

### Rregulloni kontaktin me media të reja

Shfrytëzimi i mediave të reja (kompjuter/internet, celular, e-mail, Chat, Games, Facebook, Youtube, etj.) ofron shumë mundësi dhe është bërë një gjë e përditshme për fëmijën tuaj. Por përvoja tregon gjithashtu që këto media mund të përdoren tepër intensivisht ose për qëllime problematike (varësia nga të qenët online, Cybermobbing, paraqitja e dhunës, pornografia, etj.). Sjellja me përgjegjësi me mediat e reja duhet të mësohet nga fëmijët dhe të rinjtë.

- Mos vendosni televizorin dhe kompjuterin në dhomën e fëmijëve, por në një dhomë për të gjithë familjen.
- Interesohuni për aktivitetet e fëmijës suaj në internet dhe lëreni që ai t'ju tregojë cilat janë lojërat që luan dhe cilat janë forumet e komunikimit dhe faqet e uebit që viziton.
- Merruni vesh me fëmijën tuaj për rregulla të qarta për konsumin e mediave dhe për konsekuencat në rast të mosrespektimit të tyre: Caktoni kohëzgjatjen për ditë / javë, programe, lojëra dhe faqe të internetit, rregullat e sjelljes në internet, të cilat janë të përshtatshme.
- Vini re kufirin e moshës në rast të programeve televizive dhe lojërave të kompjuterit.
- Mbështetni fëmijën tuaj në organizimin aktiv të kohës së lirë me familjen ose bashkëmohatarët dhe në lëvizjen e rregullt në natyrë.

Këshilla për kontaktin me mediat e reja në gjuhë të ndryshme:

[www.migesplus.ch](http://www.migesplus.ch) > [Enfant & santé](#)  
[www.sucht-info.ch](http://www.sucht-info.ch) > [Lettre aux parents No 8](#)  
[www.cybersmart.ch](http://www.cybersmart.ch)

## 8 Glosar

### Çlirime

*Dispenses*

Çlirimet janë lirime nga mësimi për mungesa të rregullta ose për një kohë më të gjatë. Ato duhet të planifikohen paraprakisht dhe duhet të kërkohen me një lutje me shkrim tek drejtorja e shkollës.

### Drejtorja e shkollës

*Direction d'école*

Drejtorja e shkollës është përgjegjëse për udhëheqjen pedagogjike dhe organizative të klasës. Ajo iu përcakton fëmijëve klasat e veçanta dhe është kompetente për vendimet lidhur me karrierën e shkollës.

### Drejtorja për edukim

*Direction de l'instruction publique*

Drejtorja për edukim është autoriteti kantonal në fushën e arsimit. Ajo përcakton kushtet kornizë për shkollat fillore në komunat dhe i lëshon planet mësimore.

### Inspektorati i shkollës

*Inspection scolaire*

Inspektorja e shkollës ose inspektori i shkollës ushtron mbikëqyrjen kantonale mbi shkollën fillore.

### Këshillimorja për edukim

*Service psychologique pour enfants et adolescents (SPE)*

Personat e specializuar të këshillimores për edukim këshillojnë familje, fëmijë dhe të rinj në situata të vështira dhe sqarojnë arsye për vështirësi në të mësuarin. Ata punojnë në këshillimoret rajonale për edukim.

### Komisioni i shkollës

*Commission scolaire*

Komisioni i shkollës kujdeset që fëmijët, sipas legjislacionit kantonal dhe paracaktimeve të komunës suaj, të vizitojnë kopshtin e fëmijëve dhe shkollën. Përveç kësaj ai është kompetent për vendime strategjike të shkollës suaj fillore.

### Komuna

*Commune*

Komuna është kompetente për organizimin e shkollës fillore në vend. Ajo vë në dispozicion infrastrukturën shkollore: ndërtesën e shkollës, mobiljet dhe mjetet mësimore. Në faqen e internetit ose tek sporteli i administratës së komunës ju merrni informacione për ofertën publike.

### Konsultim për zgjedhjen e profesionit

*Orientation professionnelle*

Personat e specializuar të konsultimit për zgjedhjen e profesionit mbështesin të rinjtë dhe të rriturit me informacione dhe këshillime në zgjedhjen e një formimi të përshtatshëm të profesionit për ata ose të një kualifikim të përshtatshëm të mëtejshëm. Ata punojnë në qendrat rajonale të informacionit për profesionet (**centre OP**).

### Mungesat

*Absences*

Mungesat janë mungesat nga mësimi.

### Person i specializuar

*Spécialiste*

Persona të specializuar janë kualifikuar veçanërisht për një detyrë të caktuar. Mësuese dhe mësues janë persona të specializuar për mësimdhënien dhe për të mësuarit. Persona të tjerë të specializuar i mbështesin mësueset dhe mësuesit dhe prindërit në detyrën e tyre të arsimit dhe edukimit. Kështu për shembull personat e specializuar të këshillimores për edukim, të punës sociale shkollore dhe të këshillimores për zgjedhjen e profesionit.

### Personi mësimdhënës i klasës

*Maître ou maîtresse de classe*

Personi mësimdhënës i klasës është përgjegjës për udhëheqjen pedagogjike dhe organizative të klasës. Ai është personi i parë i kontaktit për të gjitha pyetjet dhe kërkesat rreth vizitës së fëmijës suaj në kopsht dhe në shkollë.

### Puna sociale shkollore / Ndërmjetësimi shkollor

*Médiation scolaire*

Një punëtorë sociale në shkollë ose një ndërmjetësues shkollor u ofron fëmijëve dhe të rinjve ndihmë dhe këshillim në probleme sociale ose personale. Ata këshillojnë edhe persona mësimdhënës dhe prindërit.

### Mentions légales

L'école obligatoire dans le canton de Berne  
Informations à l'attention des parents  
de la partie francophone du canton (édition 2013)  
Langue: Albanais (DM 752025-v1)

Editeur

Direction de l'instruction publique du canton de Berne  
Office de l'enseignement préscolaire et obligatoire,  
du conseil et de l'orientation (OECO)  
[www.erz.be.ch/ecole-obligatoire](http://www.erz.be.ch/ecole-obligatoire), [oeco@erz.be.ch](mailto:oeco@erz.be.ch)

N'existe pas en version imprimée.

Téléchargement : [www.erz.be.ch/info-parents](http://www.erz.be.ch/info-parents)

Sources des images :

Les images sont protégées par les droits d'auteur.

Toutes les images sauf celle de la page 1 :

Christoph Heilig | [www.foto-heilig.ch](http://www.foto-heilig.ch)

Page 1 : DR